

INFORMACIONE



KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

PASQYRA E AKTIVITETEVE TE MUAJIT MAJ

1-9 Maj	Olimpiku Special Java Europiane e Futbollit
6 Maj 2004	KOKSH & AEFS Vizita Makolin/Zvicër Konferencë Shtypi
6 Maj 2004	KOKSH-MKRS-Federta e Notit
7 Maj 2004	Lojrat Mesdhetare Rinore të Notit « COMEN CUP »
7 Maj 2004	Seminari i 25 i COE për Sekretatët e Përgjithshëm dhe Shefat e Misionit
11 Maj 2004	Përgatitjet për Lojrat Olimpike “Athina 2004” Konferencë Shtypi
11-13 Maj 2004	UNDP, ILO, KOKSH dhe të tjera OJQ-Seminar « Zhvillimi i të rinjëve nëpërmjet sportit »
13-14 Maj 2004	Udhëkryqet Europiane - Sporti Dera e Përparme në Demokraci
15 Maj 2004	Dita Olimpikë e Vrapimit / Vlorë
19-20 Maj 2004	Takim me përfaqësues të AMC
21 Maj 2004	Përgatitjet për Lojërat Olimpikë « Athina 2004 » Mledhje e Komitetit Ekzekutiv
24 Maj 2004	KOMPAS II – Mbledhje Tutorëve
28 Maj 2004	Akademia Olimpikë - Quizi Olimpik
25 Maj 2004	KOKSH & Shoqata e Drejtuesve të Klubeve Shumë Sportëshe - Takim për bashkëpunim
26-29 Maj 2004	Kursi Rajonal i Administratorëve Sportiv Prefektura Durrës
29 Maj 2004	KOMPAS II Prezantimi i ecurisë së punimit të temave
31 Maj 2004	KOKSH, FIC & FSHN Kupa e Konfederatës Mesdhetare të Notit

MAJ 2004

1-9 Maj 2004 Olimpiku Special « Java Europiane e Futbollit »

Futbolli si një nga sportet më të bukur e më popullore bën pjesë në programet e Olimpikut Special, lojtarët e të cilit demonstrojnë të njëjtin passion për futbollin, ashtu si dhe miliona njerëz të tjerë në botë. Edhe këtu në Shqipëri si dhe në shumë vende të Europës me mbështetje të UEFA-s si partner kryesor i aktivitetit dhe KOKSH-it, në Pallatin e Sportit « Asllan Rusi » u zhvillua **Java Europiane e Futbollit e Olimpikut Special**.

Për më tepër se një aktivitet ajo ishte një festë ku përveç protagonistëve, u mblodhën sëbashku mësuesit, trenerët, prindërit e të afërmit, shokët e shoqet e tyre dhe njerëz humanë e shpirtmirë në përkrahje dhe mbështetje të tyre.

6 Maj 2004 KOKSH & AEFS

Vizita Makolin/Zvicër Konferencë Shtypi

Në ambjentet e AEFS « Vojo Kushi » u zhvillua konferenca për shtyp midis këtyre dy institucioneve me temë :

« *Zyra Federale e Sporteve Makolin, mundësitë e bashkëpunimit me Shqipërinë* ».

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. S.Bello, Rektori i AEFS z. S.Shtëpani dhe zv.Rektori z. B.Misja informuan gazetarët për vizitën dy ditore në Makolin e cila do të çojë në një nënshkrim për marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe në fusha të ndryshme të Sportit.

6 Maj 2004 KOKSH-MKRS-Federta e Notit

Në ambjentet e Ministrisë Kulturës Rinisë dhe Sporteve u zhvillua një takim tre palësh midis përfaqësuesve të KOKSH, MKRS dhe FSHN ku objekt i këtij takimi ishte :

-Krijimi i Grupit Organizator i Lojrave Mesdhetare Rinore « COMEN CUP » të cilat do të zhvillohen në Shqipëri në fund të muajit Qeshor.

7 Maj 2004 « COMEN CUP »

Përfaqësuesja e KOKSH E.Gjoka, Presidenti dhe Sekretari i Federatës Shqiptare të Notit, zhvilluan mbledhjen për krijimin e Strukturës Organizative për zhvillimin e Lojrave Mesdhetare Rinore « COMEN CUP » të cilat do të zhvillohen në Shqipëri.

7 Maj 2004

Seminari i 25 i COE për Sekretarët e Përgjithshëm dhe Shefat e Misionit (Beograd)

Beogradi ishte vendi organizator Seminarit të 25 i COE për Sekretarët e Përgjithshëm dhe Shefat e Misionit.

Ishte një shanc që 48 delegacionet të cilët morrën pjesë, të diskutonin për çështje të ndryshme delikate që kanë të bëjnë me « Athina 2004 » dhe në veçanti, me sigurinë. Por ndër të tjera çështje të këtij takimi ishin edhe Lojrat e Torinos, Beijingut, Vankuverit, etj.

Delegacioni ynë u përfaqësua me Sekretarin e Përgjithshëm z.S.Bello dhe Shefi i Misionit z. Fidel Ylli.

Një pikë shumë e rëndësishme e këtij takimi ishte dhe kandidimi i KOKSH për organizimin e këtij Seminarit vitin tjetër në Tiranë. Me gjithë masat e marra për një kandidim serioz, ky seminar e aprovoi kandidaturën tonë për organizimin e Seminarit të 26-të në Tiranë dhe gjithashtu Presidenti i COE konfirmoi vizitën e tij të punës në Tiranë në Korrik 2004.

11 Maj 2004 Konferencë Shtypi Përgatitjet për Lojrat Olimpike «Athina 2004»

Shefi i Misionit i KOKSH për Lojrat Olimpike «Athina 2004» z. Fidel Ylli, në ambjentet e KOKSH dha një konferencë për shtyp me temë:

« *Përgatitjet për Lojrat Olimpike «Athina 2004»* »

Z. Ylli informoi gazetarët për masat e marra dhe punën e bërë deri tani për pjesëmarrjen e Ekspicit Olimpik në «Athina 2004», numrin e pjesëmarrësve, emrat dhe disiplinat të cilat do të marrin pjesë, afatet e regjistrimit, pjesëmarrjen në kampin rinor të një vaje dhe një djali, për realizimin e kostumit zyrtar të Ekspicit Olimpik dhe gjithashtu për masat e marra në kuadër të kontrollit anti-doping.

Në këtë konferencë për shtyp z. F.Ylli gjeti rastin të informojë për aprovimin e kandidaturës së Shqipërisë për të Organizuar vitin e ardhshëm në Tiranë Seminarin e radhës të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe shefave të Misionit të COE.

11-13 Maj 2004 Seminar, UNDP, ILO, KOKSH dhe të tjera OJQ « Sporti si një mjet që promovon zhvillimin »

Duke marrë shkas nga rezoluta 58/5 e Kombeve të Bashkuara (UN)

– « Sporti si një mjet për të promovuar edukim, shëndet, zhvillim dhe paqe », UNDP, KOKSH dhe ILO

organizuan seminarin tre ditore i cili u zhvillua në ambjentet e qendrës Shalom në Tiranë.

Përfaqësues të MKRS, KOKSH, organizatave kryesore të UN, OJQ të ndryshme, AEFS «Vojo Kushi», mësues të edukimit fizik, etj. morën pjesë në këtë seminar.

UNDP, ILO dhe KOKSH ishin partnerë në organizimin e këtij Seminari i cili shte i pari i këtij lloji në Shqipëri për nga tematika që ai trajtoi.

Qëllimi i këtij seminari ishte : -Organizimi i një strukture të përbashkët për partnershipin në Sport dhe zhvillimin social-ekonomik të të Rinjëve në Shqipëri.

Seminari pati një gamë të gjerë trajtimesh dhe diskutimesh të çështjeve për zhvillimin e rinisë nëpërmjet sportit. Një kontribut mjaft të madh në këtë Seminar dhanë përfaqësuesit e KOKSH për idetë dhe mendimet e qarta që kanë të bëjnë me sportin. Gjithashtu, Sekretari i Përgjithshëm z. S.Bello prezantoi punën e bërë deri tani nga KOKSH për zhvillimin e të rinjëve nëpërmjet Sportit dhe projekteve në vazhdim.

E veçantë dhe me interes ishte Paketa Edukimit Olimpik në shkollë e prezantuar nga z.Arben Kaçurri, Drejtor i Akademisë Olimpike.

13-14 Maj 2004 Strasburg **Udhëkryqet Europiane - Sporti Dera e Përparme në Demokraci**

Këshilli Europës së bashku me Komisionin Europian dhe në bashkëpunim me Organizatat Sportive qeveritare dhe jo qeveritare Europiane, organizuan një seminar mbi Edukimin nëpërmjet Sportit të quajtur : « *Udhëkryqet Europiane - Sporti Dera e Përparme në Demokraci* ».

Në këtë seminar Shqipëria u përfaqësua me z. Arjan Konomi si përfaqësues qeveritar, Specialist i Sportit në MKRS dhe E.Gjoka, përfaqësuese e KOKSH.

Siç edhe titulli i këtij Seminari “Udhëkryqet Europiane” të gjithë të ftuarit u mbledhën së bashku për të ndarë njohuritë, eksperiencat dhe idetë në mënyrë për të favorizuar në një kontribut më të rëndësishëm lëvizjen sportive në edukimin e qytetarisë në demokraci.

15 Maj 2004 Dita Olimpike e Vrapimit / Vlorë

Në kuadrin e organizimit të DITES OLIMPIKE TE VRAPIMIT, ku qëllimi kryesor është **të promovojë praktikimin masiv të sportit**, si në shumë vende dhe qytete të botës ku ky aktivitet zhvillohet, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar më 15 Maj 2004 organizoi në qytetin e Vlorës këtë aktivitet i cili u arrit më së miri duke mbledhur së bashku të gjithë nxënësit e shkollave të të gjitha cikleve shkollore. Për fat të mirë ky aktivitet koçidoi edhe me ditën e çeljes së sezonin turistik në Vlorë ku aktivitetet ishin të larmishme dhe pjesëmarrja ishte entuziaste.

19-20 Maj 2004 Takim me përfaqësues të AMC

Objekti i këtij takimi ishte i fokusuar mbi vazhdimin e projekteve që ka KOKSH me AMC dhe për promovimin e Ekipit Olimpik i cili do të marrë pjesë në « Athina 2004 ».

Për promovimin e Skuadrës Olimpike me mbështetje të AMC janë projektuar aksesore promovionale si T-shirte, stilolapsa, medalionë, etj.

Një nga projektet e propozuara nga KOKSH ishte dhe « Shtëpia Olimpike » në Athinë e cila do të jetë një vend ku do të shërbejë për pritje dhe takime të ndryshme midis bashkëkombasve dhe të tjerë që janë të interesuar për Shqipërinë, sportin dhe kulturën tonë.

21 Maj 2004 Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv **Lojërat Olimpike « Athina 2004 »**

Komiteti Ekzekutiv zhvilloi mbledhjen e radhës në ambjentet e « House of Arts » ku morrën pjesë të gjithë anëtarët e tij.

Objekti takimit kishte të bënte me ecurinë e përgatitjeve për Lojërat Olimpike « Athina 2004 ».

Takimi u çel nga Presidenti z.Hysen Domi ku dhe paraqiti pikat e diskutimit të mbledhjes. Më pas Sekretari i Përgjithshëm z.Stavri Bello raportoi mbi ecurinë e deritanishme dhe masat e marra për promovimin e Ekipit Olimpik nëpërmjet ...

24 Maj 2004 KOMPAS II – Mbledhje Tutorëve

Tutorët e Kursit Olimpik të Menaxhimit për Administratorët e Sportit (KOMPAS II) zhvilluan një mbledhje në AEFS «Vojo Kushi» ku analizuan ecurinë e KOMPAS II dhe diskutuan për marrjen e masave për realizimin me sukses të Seminarit të Dytë të KOMPAS II. Sipas rregullave të përcaktuara, Tutorët vendosën që në fund të Majit kursantët të prezantojnë 10 slide në Poëer Point të temës së tyre dhe të fillojnë përgatitjen e materialeve me shkrim.

27 Maj 2004 Quizi Olimpik

Akademia Olimpike (AO) në bashkëpunim me AEFS «V. Kushi» organizoi « QUIZ OLIMPIK ». Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin studentët e AEFS-s të cilët të ndarë në 6 grupe konkurruan me njëri-tjetrin dhe ballafaqan njohuritë e tyre mbi Olimpizmin dhe Lëvizjen Olimpike. Prezent në aktivitet ishte Drejtori i AO z. A.Kaçurri dhe

anëtarë të kësaj Akademie z. I.Gaxho, z. Kliton Muça dhe z. A.Qelesi i cili ishte dhe drejtuesi i aktivitetit. Në fund të aktivitetit, pjestarëve të grupit i cili fitoi, iu dhurua diçka simbolike nga Drejtori i AO z. Kaçurri.

25 Maj 2004 KOKSH & Shoqata e Drejtuesve të Klubeve Shumë Sportëshe

Sekretari i përgjithshëm i KOKSH dhe një një përfaqësi e Shoqatës së Drejtuesve të Klubeve Shumë Sportëshe zhvilluan një takim dypalësh në abjentet e KOKSH. Objekti i këtij takimi ishte bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve për përmirësimin dhe rregullimin e marrdhënieve dhe kushteve në fushën e sportit.

26-29 Maj 2004 Prefektura Durrës Kursi Rajonal i Administratorëve Sportiv

Në vazhdim të projektit për trainimin e Administratorëve Sportiv Rajonal, KOKSH me mbështetjen financiare të Solidaritetit Olimpik dhe mbështetjen koordinative të Prefekturës së Durrësit, organizoi në prefekturën e Durrësit një kurs intensiv katër ditor. Organizimi i këtij kursi i cili numërohet i 5-ti në rang prefekturë ka për qëllim

- ngritjen e strukturës kombëtare të Administratorëve të Sportit,
- rritja e nivelit të njohurive mbi menaxhimin bashkëkohor në Sport dhe të tjera çështje.

Ky kurs u drejtua nga lektorë të aprovuar nga CIO, me tema për menaxhimin në sport dhe përhapjen e frymës olimpike.

Lektorët :

S.Bello, L.Tase, G.Panariti, A.Kaçurri, F. Ylli,
A. Jorgoni, E.Gjoka, V. Shqevi, S. Preçi, R.Mane

25 pjesmarrësit të cilët përfituan në këtë kurs ishin përfaqësues të bashkive, komunave, Klubeve Shumë Sportësh, Edukatorë të edukimit fizik, etj.

29 Maj 2004 KOMPAS II Prezantimi i ecurisë së punimit të temave

Në AEFS «V. Kushi» u zhvillua seanca e tetë e Kursit Olimpik të Menaxhimit për Administratorët e Sportit II. Studentët e këtij kursi prezantuan ecurinë e temës së tyre me më shumë se 10 slide e cila ishte dhe faza e dytë e paraqitjes, ku i hap rrugën një faze të tretë dhe përfundimtare deri në mbrojtje të temave të tyre. Studentët do të kenë edhe një seminar në muajin Qeshor dhe do t'i jepet kohë gjatë muajve të verës për të punuar dhe kompletuar temat e tyre.

31 Maj 2004 Kupa e Konfederatës Mesdhetare të Notit

Në mjediset e KOKSH, Sekretari i Përgjithshëm S.Bello priti Presidentin e Federatës Botërore të Kronometristëve z. Mikele Bonate, Presidentin e FSHN z.Lirim Fejzollari dhe Sekretaren e Përgjithëshme znj. Hyrmete Gjeta.

Takimi u fokusua në dy objektiva kryesore :

1. Shërbimi profesional elektronik i kronometrazhit të garave të Kupës së Konfederatës Mesdhetare të Notit *Të rinj, Të reja e cila do të zhvillohet më 25-27 Qershor 2004, Tiranë, Shqipëri.*
2. Krijimin e mundësive për ngritjen në Shqipëri të Federatës Shqiptare të Kronometristëve.

Në përfundim të takimit, të gjitha palët e pranishme u shprehën për një bashkëpunim të frytshëm dhe të suksesshëm.

Këto informacione mund ti gjeni edhe në adresën e internetit të KOKSH

www.nocalbania.org.al

në rubrikën « INFORMACIONE »

Në këtë faqe do të gjeni edhe shumë informacione të ndryshme rreth Olimpizmit dhe Lëvizjes Olimpike në botë e në vend, Misionit të KOKSH, Projektet, Aktivitetet dhe Publikimet e ndryshme në funksion të Sportit dhe Lëvizjes Olimpike.



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

President: ***Hysen DOMI***

Sekretar i Pwrgjithshwm: ***Stavri BELLO***

www.nocalbania.org.al

E-mail: secretariat@nocalbania.org.al

Adresa:

Rruga "Dervish Hima"

Nr.31 Tiranë

Tel: +355 4 235 249 / 240 602

Fax: +355 4 240 565